


Tregtia e jashtme e mallrave

Nëntor 2025

Tiranë, më 17 Dhjetor 2025: Në Nëntor 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 28 mld lekë, duke u ulur me 6,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 10,1 %, në krahasim me Tetor 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 71 mld lekë, duke u ulur me 3,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 11,1 %, në krahasim me Tetor 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 43 mld lekë, duke u ulur me 0,3 %, krahasuar me Nëntor 2024 dhe me 11,7 %, në krahasim me Tetor 2025.


Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në këtë njëmbëdhjetëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 319 mld lekë, duke u ulur me 7,0 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 807 mld lekë, duke u ulur me 1,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 488 mld lekë, duke u rritur me 3,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:


Gjatë muajit Nëntor 2025, në rënien e eksporteve prej 6,9 %, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,0 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje. Pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makinë, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,4 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me nga +0,3 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2025

Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori janë ulur me 7,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -5,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -1,6 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Nëntor 2025, në uljen e importeve prej 3,0 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi.” me -1,5 pikë përqindje dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje dhe “Prodhime druri dhe letre” me +0,3 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2025

Si njëmbëdhjetëmujor, importet janë ulur me 1,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,0 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,8 dhe pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Nëntor 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2024 janë: Italia (7,6 %), Gjermania (22,1 %), Spanja (17,6 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (6,9 %), Greqia (6,2 %), Kina (0,1), etj.

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,7 %), Kosova (11,2 %) dhe Kina (0,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Greqia (6,7 %) Gjermania (2,3 %) dhe Spanja (23,6 %).

Në muajin Nëntor 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (1,5 %), Greqia (2,8 %), Gjermania (8,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (7,4 %), Turqia (17,0 %), SHBA (10,3 %) etj.

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (1,8 %), Turqia (12,5 %) dhe Gjermania (6,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (22,6 %), Greqia (3,5 %) dhe Kosova (2,2 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 58,3 %, të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,8 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,9 %), Kina (10,5 %), Turqia (8,3 %), Greqia (7,2 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetëmujorin 2025, me vendet e BE-së zënë 57,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Nëntor 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,3 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,2 %), Kina (10,4 %), Greqia (7,7 %) dhe Turqia (7,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Nëntor 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		367	35,0	784	29,6	-423	46,0
2022		481	30,9	950	21,2	-464	51,2
2023		430	-10,4	873	-8,2	-432	50,5
2024		369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2023	01 - 23	42	20,4	58	5,8	-16	71,9
	02 - 23	38	3,6	69	1,1	-32	54,4
	03 - 23	42	-9,7	81	-3,7	-39	51,8
	04 - 23	34	-19,6	75	-3,9	-41	45,1
	05 - 23	39	-11,9	81	1,2	-41	49,0
	06 - 23	37	-17,9	75	-7,5	-38	49,9
	07 - 23	35	-10,4	71	-13,6	-36	49,3
	08 - 23	24	-29,7	68	-15,0	-44	35,6
	09 - 23	33	-13,1	73	-16,6	-40	45,2
	10 - 23	36	-4,1	78	-6,3	-42	46,7
	11 - 23	33	-21,5	72	-7,4	-39	45,8
	12 - 23	37	-6,5	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj. 23	430	-10,4	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	29	-30,0	60	3,4	-31	48,7
	02 - 24	32	-16,0	74	6,4	-42	43,0
	03 - 24	33	-20,8	75	-7,0	-42	44,1
	04 - 24	34	2,2	75	0,6	-41	45,7
	05 - 24	35	-12,5	79	-1,6	-45	43,5
	06 - 24	34	-8,6	77	2,1	-42	44,7
	07 - 24	33	-6,1	85	21,1	-53	38,2
	08 - 24	22	-8,4	69	1,9	-47	32,0
	09 - 24	30	-8,2	71	-3,1	-41	42,9
	10 - 24	31	-15,4	77	-1,5	-46	40,1
	11 - 24	30	-8,3	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	25	-31,4	79	8,3	-53	32,2
	Jan-Dhj. 24	369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2025	01 - 25	28	-4,5	60	0,1	-32	46,4
	02 - 25	30	-5,3	68	-8,6	-37	44,6
	03 - 25	31	-4,9	74	-1,4	-42	42,5
	04 - 25	30	-13,3	76	0,5	-46	39,5
	05 - 25	32	-7,9	78	-2,1	-46	41,0
	06 - 25	31	-9,0	77	-0,2	-45	40,8
	07 - 25	30	-6,9	83	-2,4	-53	36,5
	08 - 25	20	-8,4	67	-2,7	-47	30,1
	09 - 25	27	-10,7	75	5,6	-48	36,3
	10 - 25	31	1,0	80	3,6	-49	39,1
	11 - 25	28	-6,9	71	-3,0	-43	39,5
	Jan-Nën 25	319	-7,0	807	-1,0	-488	39,5

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milione lekë), Nëntor 2025

	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2024	Nëntor 2025	Jan.-Nën. 2024	Jan.-Nën. 2025	Nëntor 2024	Nëntor 2025	Jan.-Nën. 2024	Jan.-Nën. 2025
Vendet e BE-së	22,730	20,965	246,125	233,325	36,975	36,700	420,423	414,546
Austri	153	174	2,241	1,608	610	455	7,192	6,225
Gjermani	2,028	1,580	20,378	20,838	5,237	4,769	58,514	54,902
Greqi	1,862	1,978	20,379	21,744	5,311	5,164	62,316	64,474
Itali	13,777	12,730	151,652	135,351	16,078	15,835	173,726	170,583
Spanjë	1,067	879	11,942	14,761	927	984	12,085	13,355
Kroaci	337	336	2,747	2,556	349	524	4,592	6,523
Të tjera të BE-së	3,507	3,288	36,786	36,467	8,464	8,968	101,999	98,485
Mbretëri e Bashkuar	104	104	1,366	1,050	733	496	8,742	7,637
Kinë	700	701	9,926	9,919	8,982	9,650	87,316	107,057
Kosovë	2,443	2,612	34,142	30,307	1,031	1,607	14,447	14,771
Maqedonia e Veriut	730	665	11,112	7,996	1,056	919	10,902	13,020
Rusi	-	-	7	6	287	288	3,622	3,559
SHBA	353	276	6,538	5,147	1,237	1,365	17,997	16,073
Turqi	717	497	4,223	4,811	6,574	7,692	88,572	77,491
Ukrainë	163	72	3,095	459	254	276	3,631	3,174
Zvicër	99	129	2,039	1,340	829	676	8,821	9,185
Të tjera	2,034	1,990	24,872	24,977	15,088	11,205	151,096	140,942
Gjithsej	30,073	28,010	343,446	319,337	73,044	70,872	815,570	807,454

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milione lekë), Nëntor 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2024	Nëntor 2025	Jan.-Nën. 2024	Jan.-Nën. 2025	Nëntor 2024	Nëntor 2025	Jan.-Nën. 2024	Jan.-Nën. 2025
Gjithsej	30,073	28,010	343,446	319,337	73,044	70,872	815,570	807,454
Ushqime. pije. duhan	5,394	5,116	48,410	51,208	12,106	12,894	142,719	147,989
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	4,648	3,457	62,571	57,191	7,190	7,352	84,136	90,398
Produkte kimike dhe plastike	1,044	1,147	14,084	12,029	9,482	9,328	105,835	107,546
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	178	190	1,875	1,740	893	878	10,704	10,201
Prodime druri dhe letre	866	834	9,223	9,090	2,263	2,493	27,077	27,060
Tekstile dhe këpucë	9,344	9,043	97,817	96,623	7,278	7,141	79,487	79,034
Materiale ndërtimi dhe metale	3,780	3,883	62,159	45,024	9,305	8,717	111,192	103,265
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	3,387	3,506	34,887	36,808	19,972	18,903	216,107	205,813
Të tjera	1,432	834	12,421	9,625	4,555	3,167	38,313	36,148

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Nëntor 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	151,652	135,351	34,142	30,307	20,379	21,744	20,378	20,838
Ushqim, pije duhan	12,943	10,953	5,816	6,520	3,997	4,404	1,778	1,753
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	12,177	3,812	8,583	13,424	1,700	1,085	5,315	3,972
Produkte kimike dhe plastike	5,118	4,035	3,722	2,694	853	791	68	52
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1,593	1,416	6	15	156	176	1	2
Prodhime druri dhe letre	4,835	4,757	1,134	1,057	1,447	1,403	129	118
Tekstile dhe këpucë	73,283	69,863	157	142	7,298	8,858	8,628	9,503
Materiale ndërtimi dhe metale	19,666	18,313	11,715	2,971	3,990	3,937	960	822
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	17,204	17,296	1,802	2,480	226	238	3,071	4,143
Të tjera	4,834	4,907	1,208	1,003	712	852	428	472

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Nëntor 2025

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	173,726	170,583	87,316	107,057	88,572	77,491	62,316	64,474
Ushqim, pije duhan	29,482	32,106	1,614	1,938	4,925	4,692	17,478	19,135
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3,989	8,500	18	13	9,816	7,416	10,225	9,472
Produkte kimike dhe plastike	21,573	21,210	7,018	7,994	11,090	10,741	10,261	11,150
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8,234	7,745	898	907	342	381	136	148
Prodhime druri dhe letre	5,618	5,708	1,881	2,306	4,264	4,295	3,709	3,851
Tekstile dhe këpucë	33,054	31,741	13,105	14,296	11,190	9,336	5,775	6,793
Materiale ndërtimi dhe metale	20,154	18,663	11,670	17,478	26,716	25,430	8,533	7,287
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	40,312	35,781	43,274	53,035	16,423	11,188	4,064	4,563
Të tjera	11,309	9,130	7,838	9,089	3,806	4,011	2,135	2,076

Metodologjia

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifën doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri